

PROJEKT

KONTRATA FARMACI /2016

Mbështetur në ligjin nr.10383,dt.24.02.2011:”Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; në ligjin nr.105/2014: “Për Barnat dhe Shërbimin Farmaceutik” të ndryshuar; në ligjin nr.7975 dt.20.7.1995: “Për Barnat Narkotike dhe Lëndët Psikotrope” të ndryshuar; në ligjin nr.7850 dt.29.7.1994: “Kodi Civil” të ndryshuar; në ligjin nr.10279 dt.20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative” të ndryshuar; në ligjin nr.9150 dt.30.10.2003 për: “Urdhërin e Farmacistëve” të ndryshuar; në ligjin nr.10081 dt.23.02.2009: “Për Licensat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; në ligjin nr.10107 dt.30.03.2009: “Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”; në ligjin nr.9887 dt.10.03.2008: “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” të ndryshuar; në VKM nr.144 dt.11.02.2009: “Për miratimin e formularëve të vetëdeklarimit, për të ushtruar veprimtarinë e tregtimit me shumicë të barnave, të tregtimit në farmaci dhe agjenci farmaceutike, si dhe të import-eksportit të tyre”;

PALËT KONTRAKTUESE

1. FONDI i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, nëpërmjet Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, që më poshtë do të quhet **Drejtoria Rajonale** e rrethit _____ përfaqësuar nga Z/Znj. _____ me llogari bankare nr. _____ pranë bankës _____ me adresë elektronike _____;

2. FARMACIA _____ që më poshtë do të quhet **Farmacia**, me kod (FONDI) _____ me licensë Q.K.L-së nr. _____, me nr. llogarie _____ në bankën _____, me NIPT/NUIS nr. _____, që ndodhet në adresën _____ me nr. telefoni _____; me adresë elektronike _____, me pronar/përfaqësues ligjor Z/Znj. _____ dhe me drejtues teknik Z/Znj. _____ me certifikatë nr. _____ në kushtet kur :

Farmacia synon t’u realizojë shërbimin me barna të rimbursueshme shtetasve të siguruar nëpërmjet recetave të rimbursueshme që ata paraqesin në farmaci dhe të marrë nga FONDI masën e rimbursimit të tyre sipas Listës së barnave të rimbursueshme.

Drejtuesi teknik,pronari/administratori i Farmacisë është përgjegjës për detyrimet e farmacisë të parashikuara në këtë kontratë.

Farmacia ka plotësuar kriteret e miratuara nga Këshilli Administrativ i FONDIT siç përshkruhen mëposhtë:

KRITERET

1. Farmacia të jetë e licencuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit;
2. Drejtuesi teknik të jetë paisur me çertifikatën përkatëse të Urdhërit të Farmacistëve të Shqipërisë
3. Farmacia të jetë e regjistruar pranë organeve tatimore dhe QKR;
4. Farmacia të ketë llogari bankare;
5. Farmacia që lidh kontratë për herë të parë ose pas një periudhe ndërprerjeje të ketë gjendje jo më pak se 60% të barnave alternativa të para të listës së barnave, që rimbursohen në sasi të tillë jo më pak se sa mjekimi mujor sipas protokollit të përdorimit;
6. Drejtuesi teknik i Farmacisë të drejtojë vetëm farmacinë për të cilën është licensuar;
7. Farmacia të plotësojë standardet frigoriferike për ruajtjen dhe tregtimin e barnave termolabile;
8. Farmacia të jetë e pajisur me kasafortë të fiksuara në mur betoni për ruajtjen e barnave narkotike dhe helmet e tabelës II.(Kur ajo është e licencuar t'i tregtojë ato);
9. Farmacia të jetë e pajisur me kompjuter për të realizuar kompjuterizimin e të dhënave, sipas programeve të përgatitura nga FONDI;
10. Drejtuesi teknik i Farmacisë dhe farmacistët e punësuar, të jenë anëtarë të Urdhërit të Farmacistëve të Shqipërisë;
11. Farmacistët dhe nd/farmacistët e punësuar, të kenë kontratë punësimi me pronarin/ përfaqësuesin ligjor të Farmacisë;
12. Nuk lidhet kontratë me Agjencitë Farmaceutike në qytetet dhe fshatrat ku ka Farmaci me kontratë;
13. **Nuk lidhet kontratë me Farmacitë të cilat janë në proces gjyqësor me FONDIN/Drejtorinë Rajonale.**

Kjo pikë bie në kundërshtim me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të sanksionuara në nenin 15 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë , “Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre”

Kjo pikë çënon gjithashtu të drejtën e ankimit të subjekteve ndaj veprimeve arbitrare të administratës publike.

Kërkojmë heqjen e kësaj pike nga kriteret për lidhjen e kontratës.

14. Nuk lidhet kontratë me Farmacitë të cilat janë në hetim nga organi akuzës për çështje që lidhen me pikat e kësaj kontrate deri në përfundimin e plotë të hetimeve.
15. Farmacia të ketë të vendosur në pjesën e jashtme të sajë në mënyrë të dukshme, emrin tregtar me të cilin është regjistruar pranë QKR-së.

16. Nuk lidhet kontratë me Farmacinë nëse :
- a) në mjediset e Farmacisë ushtrohet aktivitet tjetër privat ose familjar, jo farmaceutik.
 - b) mjediset e Farmacisë komunikojnë direkt(qoftë të ndarë edhe me derë) me ambiente të tjera private ose familjare.
 - c) nëse mjediset e farmacisë janë të përbashkëta me Qendrën Shëndetësore ose Spitalin, hyrja e farmacisë është ngjitur me hyrjen e Qendrës Shëndetësore ose Spitalin, farmacia nuk duhet të jetë në të njëjtin mur ndarës me Qendrën Shëndetësore ose Spitalin

Lidhje Kontrate për herë të parë:

veç sa më lart (pikat 1-17) :

1. Farmacia që lidh kontratë për herë të parë duhet të ketë mundësi hyrjeje të përshtatshme për invalidët para dhe tetraplegjikë;
2. Farmacia që lidh kontratë për herë të parë duhet të ketë sipërfaqe të shfrytëzueshme mbi 50 m². (Genplan i lëshuar nga arkitekt/inxhinier i licensuar);
3. Farmacia që lidh kontratë për herë të parë, duhet të jetë në një distancë të tillë jo më pak se 150 m (rrugë këmbësore) nga farmacia ekzistuese me kontratë(plan vendosje dhe vërtetim lëshuar nga arkitekt/inxhinier i licensuar).
4. Farmacia që lidh kontratë për herë të parë duhet të ketë një distancë të tillë jo më pak se 30 m nga hyrja e Qendrës Shëndetësore ose Spitalit.

Te gjitha pikat e mësipërme bien ndesh me nenin 118 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë thuhet” Organi i autorizuar me ligj për të nxjerrë akte nënligjore, siç specifikohet në paragrafin 2 të këtij neni, nuk mund t’ia delegojë kompetencën e tij një organi tjetër”

Të gjitha pikat e mësipërme bien ndesh me bazën ligjore mbi të cilën është hartuar kjo projekt kontratë. Fondi nuk mund të marrë kompetencat e institucioneve të tjera shtetërore duke vendosur kritere të ndryshme nga ato që janë përcaktuar me ligje, VKM dhe rregullore. Kriteret për lidhjen e kontratës duhet të jenë të bazuara në legjislacionin në fuqi dhe të unifikuara për të gjitha subjektet farmaceutike. Vendosja e kritereve të mësipërme përvesce diskriminon një pjesë të subjekteve të vend për abuzime, dhe i shërben ruajtjes së monopoleve të krijuara nga pronar farmacish të lidhur drejtpërdrejt apo tërthorazi me drejtues të FSDKSH-së.

5. Farmacia që lidh kontratë për herë të parë nuk duhet të jetë në të njëjtin mur ndarës me Qendrën Shëndetësore ose Spitalin.

Drejtoria Rajonale e Fond-it të Sigurimit tëDetyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Farmacia, ranë dakort dhe morën përsipër të drejtat dhe detyrimet për realizimin e kësaj kontrate si më poshtë:

OBJEKTI I KONTRATËS

Realizimin e skemës së sigurimit shëndetësor nga FONDI, nëpërmjet rimbursimit të pjesshëm ose të plotë të çmimeve të barnave që përdorin të siguruarit, nëpërmjet rimbursimit të recetave të ekzekutuara në Farmaci.

DETYRIMET E FARMACISË

Detyrime të përgjithshme

1. FARMACIA të mbajë në ambientin ku punon Librin e listës së barnave që rimbursohen nga FONDI dhe ta verë atë në dispozicion të pacientëve, sa herë që i kërkohet.
2. FARMACIA për periudhën që është e kontraktuar me FONDIN/Drejtorinë Rajonale duhet të vendosë në hyrje të saj:
 - emrin e saj tregtar i cili duhet të jetë i njëjtë me atë të regjistruar në QKR;
 - tabelën: “Farmaci me Kontratë me Fondin e Sigurimeve Shëndetësore” të furnizuar nga Fondi/Drejtoria Rajonale;
 - orarin dhe çdo informacion të shpërndarë nga FONDI për realizimin e skemës së sigurimeve shëndetësore. Në rast të ndërprerjes së kontratës, Farmacia duhet të heqë tabelën e mësipërme. Në rastin kur nuk e heq tabelën njoftohen organet përkatëse për ndjekjen e procedurave konform ligjit.
3. **Kur FARMACIA ndërpret aktivitetin për më shumë se një ditë (pune) duhet të lajmërojë me shkrim ose në mënyrë elektronike, Drejtorinë Rajonale për kohën e ndërprerjes; për këtë periudhë ajo nuk rimbursohet.**

Duke marrë parasysh kushtet gjeografike të vendosjes së subjekteve farmaceutike, mosgarantimin e funksionimit të internetit në cdo kohë si dhe rastet e mundshme të fatkeqësive të ndryshme , vendosja e afatit 1 ditë pune është i pamundur, paarsyeshëm dhe i pajustificuar.
Kërkojmë që afati të jetë 3 ditë pune.

4. FARMACIA është e detyruar të mbajë në ambientet e saj, dokumentet origjinale ose fotokopje të noterizuara të:
 - licensës së ushtrimit të aktivitetit;
 - të regjistrimit tatimor NIPT/NUIS;
 - të kontratave të punësimit të personelit teknik farmaceutik;
 - të certifikatave të anëtarësimit në Urdhërin e Farmacistëve (të personelit teknik farmaceutik të punësuar).
5. FARMACIA duhet të njoftojë me shkrim Drejtorinë Rajonale brenda 5 ditëve, në rastin e ndryshimit të licencës së ushtrimit të aktivitetit, të NIPT-it, të pronarit, të drejtuesit teknik, të farmacistëve të punësuar dhe të vendndodhjes (adresës) së saj.
Për mos deklarim të çdonjërit nga detyrimet e kësaj pike, pas afatit kohor të përcaktuar deri në fund të muajit pasardhës farmacisë nuk i rimbursohet vlera e recetave të ekzekutuara.

Për ndryshimet e mësipërme plotësohet formulari i Përditësimit të Vetëdeklarimit.

Në rastin e ndryshimit të pronarit, pronari i ri i Farmacisë, e ushtron aktivitetin e tij brenda afatit të kontratës në mëparshme, dhe mbart në vazhdimësi të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga kjo kontratë deri në përfundim të saj.

6. FARMACIA nuk duhet të mbajë në ambientet e saj librezat e shëndetit/karta e shëndetit, të pacientëve të cilët nuk ndodhen (janë prezent) në farmaci.
7. FARMACIA gjatë veprimtarisë së saj është e detyruar të respektojë detyrimin e ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave, në përputhje me kriteret e përpunimit të këtyre të dhënave sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

8. Farmacia është e detyruar të paraqesë pranë Drejtorisë Rajonale faturën tatimore për shumën e njohur për rimbursim.

Me shkresën Nr 32758/1 Prot. Datë 19.11.2015, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, e ka cilësuar të paligjshme këtë kërkesë të Fondit. Është ë pakuptimtë që edhe pasi FONDIT i është dërguar shkresa e DPT përsëri në kontratë përshihet një kërkesë e paligjshme. Kërkojmë heqjen e kësaj pike si të pa bazuar në ligj.

Detyrime specifike

1. FARMACIA të ushtrojë veprimtarinë vetëm në prani të drejtuesit teknik ose të farmacistit të punësuar, të deklaruar.
2. FARMACIA është e detyruar të mbajë në rregull dokumentacionin si mëposhtë:
 - a) fletë daljet e Importuesve/Shpërndarësve farmaceutikë;
 - b) regjistrin vjetor tip të fletë-hyrjeve, ku fletë-daljet e importuesve dhe shpërndarësve farmaceutikë (që janë të kontraktuar me FONDIN/Drejtorinë Rajonale), **të regjistrohen brenda 3 ditëve kalendarike, nga dita e lëshimit;**

Bazuar në ligjin për procedurat tatimore dhe TVSH, afati i regjistrimit të faturave tatimore është 30 ditë, kërkojmë që afati i regjistrimit të faturave të jetë i njëjtë me atë që përcakton ligji

- c) recetat me rimbursim dhe **pa rimbursim;**

Kontrolli i recetave pa rimbursim është Është kompetencë e AKBPM dhe jo i FSDKSH-së dhe jashtë Objektivit të Kontratës "Realizimin e skemës së sigurimit shëndetësor nga FONDI, nëpërmjet rimbursimit të pjesshëm ose të plotë të çmimeve të barnave që përdorin të siguruarit, nëpërmjet rimbursimit të recetave të ekzekutuara në Farmaci"

Theksojmë gjithashtu se mungojnë aktet nënligjore mbi recetatet pa rimbursim, mjekët nuk janë të pajisur dhe nuk përdorin receta tip pa rimbursim. Kërkojmë që fjalia "pa rimbursim të hiqet nga pika c.

- d) listëtreguesit;
- e) fletë daljet e Farmacisë për Importuesin/Shpërndarësin e origjinës (kthim barnash).

Dokumentacioni i mësipërm duhet të ketë formën dhe të jetë plotësuar siç paraqitet në kapitullin **“Dokumentacioni i Farmacisë”** të kësaj kontrate.

Dokumentacioni i farmacisë duhet të qëndrojë në farmaci,gjatë kontrollit të ushtruar nga FONDI/Drejtoria Rajonale, dokumentacioni i munguar duhet të rikthehet në farmaci brenda ditës dhe në rastet kur dokumentacioni është marrë për shqyrtim nga ndonjë institucion tjetër,duhet të paraqitet procesverbali i marrjes së këtij dokumentacioni.

FARMACIA është e detyruar të ruajë dokumentacionin e mësipërm për një periudhë kohore sipas legjislacionit në fuqi dhe t’i verë në çdo kohë në dispozicion të Drejtorisë Rajonale për qëllime kontrolli dhe për kryerjen e inventareve.

FARMACIA të japë informacionet që i kërkon Drejtoria Rajonale dhe FONDI.

3. FARMACIA tregton barnat e Listës së barnave që rimbursohen vetëm kundrejt recetës së mjekut,me përjashtim të barnave OTC (barna që jepen pa recetën e mjekut) sipas listës së miratuar nga Ministri Shëndetësisë.

4. FARMACIA, recetat me rimbursim sipas formatit tip të miratuar nga FONDI, t’i pranojë vetëm të shoqëruara me fletën e librezës së shëndetit ose me kartën e shëndetit.

Në pjesën e caktuar të librezës së shëndetit,Farmacia plotëson qartë dhe pa gabime barnat e dhënë,të cilët duhet të përputhen me fletën përkatëse të librezës së shëndetit.

Fleta e librezës së shëndetit firmoset nga pacienti pasi merr barnat (mjafton një firmë pavarësisht nga numri i barnave të marra).

5. FARMACIA të ekzekutojë recetat saktësisht sipas udhëzimeve në fuqi, ajo nuk duhet të pranojë receta të plotësuara me mangësi nga mjeku, pasi në asnjë rast nuk do të rimbursohen recetat të cilave u mungon një prej elementeve të mëposhtëm:

- a. Numri i serisë së recetës
- b. emër mbiemër pacienti
- c. kodi i pacientit
- d. datëlindja
- e. nr. Regjistrimit
- f. të jetë zgjedhur kategoria
- g. diagnoza
- h. kodi i diagnozës
- i. tipi i sëmundshmërisë
- j. kodi i QSH
- k. data e lëshimit të recetës
- l. kodi i mjekut

- m. firma vula e mjekut
- n. vula e institucionit
- o. data ekzekutimit të recetës
- p. numri i recetës për farmacinë
- q. firma e farmacisë
- r. vula e farmacisë

Gjithashtu nuk do të rimbursohen recetat të cilat nuk përmbushin rregullat e mëposhtme:

- s. Përshkrimi i barnave sipas emërimit xhenerik (përfshijë veteranet dhe invalidët e luftës)
- t. Respektimi i numrit të barnave në recetën me rimbursim të pjesshëm (jo më shumë se tre barna)
- u. Lëshimi i recetës së veçantë për barnat narkotike dhe psikotrope
- v. Që receta të jetë lëshuar për një diagnozë

Receta është dokument mjekësor, juridik, financiar, nuk ka asnjë logjikë juridike, mjekësore dhe financiare që ta bëjë të pavlefshme një dokument nëpërmjet të cilit është ezauruar qëllimi i FSDKSH, Konkretisht, farmacia i ka dhënë barnat pacientit, farmacia ka bërë transaksionin financiar, receta si dokument juridik mund të plotësohet nga mjeku që e ka lëshuar atë., dhe pasi të jetë plotësuar të pranohet për rimbursim.

Gjithashtu heqja e vlerës së gjithë recetës kur vetëm njëri nga barnat rezulton të jetë përshkruar në “mënyrë të parregullt” është i padrejtë dhe abuziv.

Kërkojmë që të riformulohet kjo pikë duke bërë të mundur kthimin në farmaci për plotësime shoqëruar me një penaltet bazuar në proporcionalitet.

6. FARMACIA të pranojë dhe ekzekutojë receta me rimbursim:

- a) brenda treditëve recetat me antibiotikë;
- b) brenda shtatëditëve nga data e lëshimit, recetat e tjera me rimbursim.

7. FARMACISË i rimbursohet vetëm bari:

- a) i firmave farmaceutike prodhuese, të përcaktuara në listën e barnave që rimbursohen nga FONDI, me përjashtim të rasteve pika 10 a;
- b) i pajisur me pullën e kontrollit të Ministrisë së Shëndetësisë (AKBPM -së);
- c) itregtuar vetëm nga Importuesi/Shpërndarësi Farmaceutik, që ka kontratë me FONDIN.

Rimbursimi do të bëhet në masën e parashikuar për barin si alternativë e parë, përcaktuar si referencë në listën e barnave që rimbursohen.

8. FARMACIA të zbatojë rigorozisht çmimet e shitjes së barnave sipas listës në fuqi dhe të kërkojë rimbursim për barnat e listës.

9. FARMACIA të kërkojë nga të siguruarit Kartën e shëndetit/Librezën e Shëndetit. Gjithashtu farmacia arkëton nga pacienti vlerën e tarifës së recetave me rimbursim të pjesshëm, vlerë e cila i mbahet nga rimbursimi.

Për shkak të ngarkimit me xhiro fiktive e cila mund të ndryshojë rretahanat financiare kundrejt detyrimeve tatimore, tarifa e recetës me rimbursim të pjesshëm të mos arkëtohet nga farmacia por nga mjeku.

10. FARMACIA për recetat e invalidëve të luftës dhe veteranëve me sëmundje kronike:
- a.) në rastet kur bari nuk është në listën e barnave që rimbursohen, ajo bën llogaritjen e çmimit të barit, bazuar në çmimin e pasqyruar në pullën e kontrollit të vendosur në kutinë e barit. Fotokopja e faturës origjinale e vulosur nga farmacia (ku bari i dhënë shënohet me shenjë-x) t'i bashkëlidhet recetës së kësaj kategorie.
 - b.) për alternativat më të shtrenjta të barnave të listës së barnave që rimbursohen, Farmacia do të rimbursohet vetëm kur në recetë është plotësuar nga mjeku emri tregtar i barit, duke plotësuar saktësisht kodin përkatës. Në rastin kur nuk është plotësuar emri tregtar i barit, Farmacisë i rimbursohet bari në masën e alternativës së parë, sipas listës së barnave që rimbursohen.
11. FARMACIA në të gjitha llojet e recetave me rimbursim që do të ekzekutojë, nuk duhet që sasia e barnave mjekim mbajtëse të kalojë kohën prej dymuaj, me përjashtim të rasteve të miratuara nga FONDI/Drejtoria Rajonale (por jo më shumë se 6 muaj).
Farmacia të ekzekutojë recetat me rimbursim të plotë për aq barna sa përshkruhen për diagnozë, recetat me rimbursim të pjesshëm deri në tre barna për diagnozë, për kategorinë pensionistë deri në tre barna për diagnozë.

Bazuar në nenin 39 të Ligjit të Barnave dhe Shërbimit Farmaceutik, pika 1
“Tregtimi me pakicë i barit kryhet nga farmacitë dhe agjencitë farmaceutike vetëm në referim të paketimit të tij të jashtëm, sipas dispozitave të këtij ligji”
Kërkojmë që përshkrimi i barnave në recetat me rimbursim të bëhet sipas ambalazhimit të tyre.

12. FARMACIA është e detyruar të pranojë kontrollin me inventarizim dhe tematik për barnat e Listës së barnave që rimbursohen, që bën Drejtoria Rajonale ose FONDI.

Inventarizimi i barnave kryhet veçmas sipas alternativave të firmave prodhuese brenda së njëjtës formëdoze alternative të barit, ndërsa rezultati i kontrollit me inventar nxirret i përbashkët sipas alternativave të ndryshme të firmave prodhuese brenda së njëjtës formëdoze të barit.

Kontrolli dhe inventarizimi bëhet në prezencë të Drejtuesit teknik ose të farmacistit të punësuar, sipas udhëzuesve metodikë të miratuar nga FONDI, të cilët u bëhen të njohur farmacive.

Aktrakordimi përfundimtar bëhet vetëm në prezencë të Drejtuesit teknik të farmacisë.

Bazuar në ankesat që farmacistët kanë bërë, mbi kryerjen e inventareve në orë të vona kërkojmë që grupet e kontrollit me inventarizim të mos pranojnë nga farmacia pas orarit zyrtar (16⁰⁰)

13. FARMACIA është e detyruar të pranojë kontrollin me inventarizim për barnat e rimbursueshme në rastet e ndërprerjes së kontratës. Nga kontrolli i ushtruar farmacia është e detyruar të pranojë sanksionet dhe detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i kësaj kontrate.
14. FARMACIA gjatë kontrollit duhet të paraqesë dokumentacionin e saj të parashikuar në këtë kontratë sa herë që i kërkohet nga specialistët e kontrollit të Drejtorisë Rajonale apo FONDIT. Kur ky dokumentacion kërkohet për verifikim merret nga Farmacia me procesverbal nga grupi i kontrollit dhe pas verifikimit, dorëzohet përsëri në Farmaci me procesverbal brenda 15 ditëve; për recetat akoma të parimbursuara t'u kthehen brenda tre ditëve.

Farmacia kontrollohet me inventarizim për barnat e listës nga Drejtoria Rajonale, përfshirë dhe kontrollin sipas pikës 15 të mëposhtme, jo më shumë se 2 (dy) herë në vit.
15. FARMACIA kontrollohet nga Drejtoria Rajonale për periudhën e mëparshme të kontraktuar (vetëm për periudhën pas kontrollit të fundit me inventar por jo më tej se afati i kontratës paraardhëse, për barnat e rimbursueshme të cilat nuk janë kontrolluar në kontrollin e fundit me inventar, merret si periudhë e fundit koha e hyrjes në fuqi e listës së barnave që rimbursohen) bazuar në detyrimet dhe sanksionet që i përkasin asaj periudhë, përjashtojë ndërprerjen e kontratës.

Farmacisë në çdo rast do t'i zbritet nga rimbursimi vlera përkatëse e përfituar padrejtësisht, pavarësisht nga arsyet dhe nga koha në të cilën konstatohet kjo diferencë.
16. FARMACIA kontrollohet vetëm nga FONDI për periudhën e mëparshme të kontraktuar (por jo më tej se afati i kontratës paraardhëse) bazuar në detyrimet dhe sanksionet që i përkasin asaj periudhë, përjashtojë ndërprerjen e kontratës.
17. Kur nga kontrolli me inventar i ushtruar në farmaci gjatë periudhës që kjo kontratë është në fuqi rezultojnë **diferenca në plus** (gjendja fizike e barnave të listës është më e madhe se gjendja kontabël) për të cilën është rimbursuar, Farmacia është e detyruar të kthejë shumën e përfituar në mënyrë të padrejtë. Kjo shumë, i zbritet Farmacisë nga vlera e rimbursimit të muajve pasardhës.
18. FARMACIA duhet të vendosë në kollonën përkatëse të recetës, kodin e barit të përshkruar në recetë në përputhje me alternativën e barit (sipas emrit tregtar dhe firmës prodhuese) që ajo i jep pacientit.
19. FARMACIA në asnjë rast nuk duhet të mbajë në ambjentet e saj dhe të dorëzojë për rimbursim në Drejtorinë Rajonale, receta të cilat nuk janë ekzekutuar në këtë farmaci.

20. FARMACIA është e detyruar t'i japë pacientit barnat e përshkruara në recetë pa bërë asnjë lloj zëvendësimi të formë-dozës, të principit aktiv apo të sasisë së barit të përshkruar nga mjeku.

Dorëzimi dhe regjistrimi i të dhënave

1. FARMACIA duhet të dorëzojë në Drejtorinë Rajonale, dy herë në muaj:

- a) recetat me rimbursim
- b) listë treguesit analitik të recetave me rimbursim
- c) listë treguesin përmbledhës
- d) pasqyrën përmbledhëse të faturave hyrje-dalje

Dokumentat sipas pikave a, b dhe c d printohen në dy kopje nga programi eFarmacia, firmosen, vulosen dhe së bashku me recetat me rimbursim dorëzohen në datën _____, për periudhën nga data 16 deri në fund të muajit paraardhës dhe datën _____, për periudhën nga data 1 deri me 15 të çdo muaji, por jo më vonë se tre ditë pas datave të caktuara. Në raste të fuqive madhore bëhet shtyrja me marrëveshje për dorëzimin e recetave në afatin e pranuar mes palëve. Një kopje e dokumentave dorëzohet në Drejtorinë rajonale, tjetra mbahet nga Farmacia.

Në të gjitha rastet, numri rendor i recetës sipas tipit me rimbursim nis i ri në fillim të çdo viti kalendarik, përjashtuar rastet kur Farmacia lidh kontratë për herë të parë (në këtë rast numri rendor nis i ri nga ky moment).

2. FARMACIA duhet të regjistrojë në programin online eFarmacia të Fond-it:

- a) të dhënat lidhur me recetat me rimbursim, brenda 48 orëve nga koha e ekzekutimit. Në rastet e problematikave të krijuara në rrjet (vonesa 24 orëshe) për shkaqe të fuqive madhore ose të Fond-it, ai afat shtyhet dhe nuk zbatohen penalitetet;
- b) të dhënat për faturat Hyrje-Dalje të barnave të rimbursueshme, brenda 3 ditëve nga data e ekzekutimit.

Bazuar në ankesat që farmacistët kanë bërë, programi i Fondit ka probleme të vazhdueshme, prandaj kërkohet që koha e hedhjes së recetave online të bëhet 5 ditë.

Të dhënat për Faturat hyrje-dalje të regjistrohen sic e parashikon ligji i procedurave tatimore dhe TVSH, brenda 30 ditëve.

3. FARMACIA duhet të dorëzojë(vetëdeklarojë) të printuar (të firmosur dhe vulosur në çdo fletë) dhe të regjistrojë në programin online eFarmacia të Fond-it, inventarin e gjendjes fizike të barnave të listës së barnave që rimbursohen si më poshtë:

- a) kur hyn në fuqi Lista e re e barnave të rimbursueshme(gjendjen fizike të barnave të rimbursueshme si dhe të barnave që kanë dalë nga lista), brenda 15 ditëve, nga hyrja në fuqi e Listës;
- b) kur lidh kontratë për herë të parë.

DETYRIMET E DREJTORISE RAJONALE

1. DREJTORIA RAJONALE merr në dorëzim nga farmacia **ose përfaqësuesi i autorizuar i saj**, recetat me rimbursim së bashku me : listë treguesin analitik të recetave me rimbursim; listë treguesin përmbledhës dhe pasqyrën përmbledhëse të faturave hyrje-dalje duke formuar dosjen e subjektit farmaceutik. Drejtoria Rajonale harton proces-verbalin e pranimit, një kopje të cilit ia dorëzon Farmacisë si dhe konfirmon pranimin e tyre në programin e-Farmacia.

Dorëzimi i dokumentacionit të bëhet vetëm nga personat që kanë firmosur kontratën.

Të hiqet fjalia “ose përfaqësuesi i autorizuar i saj”

2. DREJTORIA RAJONALE njofton pronarin/drejtuesin teknik të farmacinë ose personin e autorizuar, për detyrimin përfundimtar të njohur për rimbursim nga Fondi dhe i dorëzon :

1-Kopjen e akt-rakordimit përfundimtar

2-Listën e recetave që nuk janë pranuar për rimbursim

Drejtoria Rajonale bën xhirimin e shumës vetëm pas paraqitjes nga ana e Farmacisë të faturës tatimore me vlerën e njohur si detyrim nga akt-rakordimi.”

Të bëhet, Drejtoria Rajonale bën xhirimin e shumës së detyrimit sipas akt-rakordimit jo më vonë se 7 ditë pune pas njoftimit të tij..”

Të hiqet fjalia “me vlerën e njohur si detyrim nga akt-rakordimi.”

Të hiqet fjalia “ose përfaqësuesi i autorizuar i saj”

4. DREJTORIA RAJONALE duhet të pajisë Farmacinë me listën e barnave që rimbursohen,regjistrin e fletë-hyrjeve, me listën e Importuesve/Shpërndarësvefarmaceutik të barnave që kanë kontratë me FONDIN/Drejtorinë Rajonale, me programin informatik falas, si edhe me aktet nënligjore të sigurimeve shëndetësore që lidhen me veprimtarinë e farmacisë. Këto informacione dhe të tjera, janë vënë në dispozicion në mënyrë elektronike, edhe në faqen zyrtare të internetit të FONDIT ëëë.fsdksh.com.al.

4. DREJTORIA RAJONALE tërheq me procesverbal nga Farmacia dhe mban për qëllime kontrolli për një afat kohor jo më shumë se 3 ditë, recetat akoma të pa rimbursuara dhe me procesverbal bën dorëzimin e tyre dhe shënon rezultatet e kontrollit.

5. DREJTORIA RAJONALE përpara çdo kontrolli njeh dhe pranon deklaratën me shkrim të Farmacisë për ndryshime të mundshme të qarkullimit të barnave dhe të dokumentacionit.

6.DREJTORIA RAJONALE nuk do të vendosë gjobë ndaj Farmacisë në rastet kur Farmacisë i zgjidhet kontrata.

Të hiqet si pikë

7. DREJTORIA RAJONALE të bëjë takime të përbashkëta periodike me farmacistët ose me përfaqësuesit e tyre të njohur nga organet kompetente për sqarimin e problemeve të lindura gjatë zbatimit të kontratës dhe udhëzimeve të ndryshme të nxjerra nga FONDI. Konkluzionet e dala protokollohen dhe u përcillen zyrtarisht farmacive.
8. Grupi i kontrollit i DREJTORISE RAJONALE apo FONDIT duhet të përbëhet jo më pak se nga 2 (dy) anëtarë, ku të paktën njëri të jetë farmacist, të pajisur me fletë identifikimi dhe urdhër kontrolli. Në rast të kundërt grupi i kontrollit nuk pranohet nga Farmacia për kontroll.
9. DREJTORIA RAJONALE duhet të njoftojë farmacinë zyrtarisht brenda 3 ditëve nga dita e marrjes së vendimit, në rastet e zgjidhjes së kontratës.
10. DREJTORIA RAJONALE do të rimbursojë Farmacinë për periudhën e ankimit administrativ deri në shpalljen e vendimit nga FONDI.
11. Të gjitha llojet e procesverbaleve, marrëveshjeve etj., bëhen në dy kopje, nga të cilat njëra i jepet Farmacisë dhe tjetra i mbetet Drejtorisë Rajonale/FONDIT.
12. Komunikimi ndërmjet FONDIT/Drejtorisë Rajonale dhe Farmacive për të gjitha çështjet që përshkruhen dhe rrjedhin nga kjo kontratë të jetë në formë elektronike, shkresore dhe e konfirmuar nga palët.
13. FONDI/Drejtoria Rajonale për të gjitha masat e mara ndaj Farmacisë për mos zbatim të kësaj kontrate njofton Farmacinë, zyrtarisht, brenda 3 ditëve nga vendimi.
14. DREJTORIA RAJONALE verifikon saktësinë e inventarit të dorëzuar nga Farmacia vetëm në rastet kur:
 - a.) farmacia lidh kontratë për herë të parë.
 - b.) farmacia rilidh kontratë pas një periudhe ndërprerje nga ana e FONDIT/Drejtorisë Rajonale.
15. DREJTORIA RAJONALE pranon nga Farmacia inventare të printuar sipas programit informatik të FONDIT (të vulosur e firmosur) pa korrigjime. Në të kundërt, inventaret nuk pranohen.
16. DREJTORIA RAJONALE gjatë veprimtarisë së saj është e detyruar të respektojë detyrimin e ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave në përputhje me kriteret e përpunimit të këtyre të dhënave sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.
17. **DREJTORIA RAJONALE në kontrollin me inventar, inventarizon jo më pak se 50 barna me konsum dhe vlerë më të lartë rimbursimi.**

Të përjashtohen nga kontrolli me inventar barnat OTC dhe barnat që nuk kanë patur konsum gjatë periudhës kontraktuale.

18. DREJTORIA RAJONALE është e detyruar të ushtrojë kontroll me inventarizim, në farmaci, për të gjithë barnat e Listes së Barnave që rimbursohen, në rastin e zgjidhjes së kontratës. Deri në daljen e rezultatit përfundimtar, farmacisë nuk i rimbursohen recetat që ajo ka të depozituara/dorëzuara në Drejtorinë Rajonale.

Të përjashtohen nga kontrolli me inventar barnat OTC dhe barnat që nuk kanë patur konsum gjatë periudhës kontraktuale.

19. DREJTORIA RAJONALE, në rastet e zgjidhjes së kontratës, heq nga subjekti tabelën me mbishkrimin “Farmaci me Kontratë me Fondin e Sigurimeve Shëndetësore”.

SANKSIONET DHE PROCEDURAT E ANKIMIMIT

Për moszbatimin e detyrimeve të kontratës palët kanë të drejtë të ushtrojnë këto sanksione:

1. Për çdo shkelje nga ana e Farmacisë të detyrimeve të saj të parashikuara në kapitullin “Detyrimet e Përgjithshme të Farmacisë” të :

a. pikave 1,2,4 vendoset gjobë në masën 5 000 lekë.

Të bëhet 500 lekë

b. pikës 3 vendoset gjobë në masën 10 000 lekë.

Të bëhet 1000 lekë

2. Për shkelje të pikës 6 të kapitullit “Detyrimet e përgjithshme të Farmacisë”, për çdo librezë shëndetësore/kartë shëndetësore të gjetur në ambientet e Farmacisë, vendoset gjobë në masën 1000 lekë .

4. Për çdo shkelje nga ana e Farmacisë të detyrimeve të saj të parashikuara në kapitullin “Detyrimet Specifike të Farmacisë” pika 2, vendoset gjobë në masën 1000 lekë.

Të bëhet 100 lekë

5. Për çdonjërën nga shkeljet nga ana e Farmacisë të detyrimeve të saj të parashikuara në pikën 1 të kapitullit “Dorëzimi dhe Regjistrimi i të dhënave” të kësaj kontrate, FONDI/Drejtoria Rajonale vendos gjobë në masën 5 000 lekë, si edhe për vonesa të dorëzimit të recetave dhe listëtreguesve përtej afatit 7 ditë (nga data e dorëzimit) vendoset gjobë në masën 5 000 lekë .

Të bëhet 500 lekë

6. Farmacisë nuk do t'i rimbursohen recetat për çdo shkelje të pikave 4, 5, 6 ,7 dhe 10.a të nënkapitullit “Detyrimet specifike të Farmacisë”.

Recetat të kthen për plotësim dhe të rimbursohen pasi të konfirmohet rregullsia e tyre.

6. Kur nga kontrolli i ushtruar rezulton se në Farmaci nuk gjendet drejtuesi teknik ose farmacisti i punësuar, por gjendet farmacist pakontratë punësimi me subjektin (vetëm për herë të parë), Farmacia paguan kusht penal në masën 50000 lekë.

Të njoftohen AKBPM dhe UFSH

6. Kur nga kontrolli me inventar i ushtruar në Farmaci gjatë periudhës që kjo kontratë është në fuqi rezultojnë diferenca në minus (gjendja fizike është më e vogël se gjendja kontabël), të pajustificuara nga 200 000 deri 500 000 lekë, Farmacia paguan kushtin penal prej 10 000 lekë.

Bazuar në objektin e kontratës kërkojmë që qarkullimi barnave me receta pa rimbursim të mos jetë pjesë e kontrolleve me inventar. Kërkojmë heqjen e kësaj pike.

8. Për çdo recetë me gabim/mungesë të kodit të barit Farmacia paguan kushtin penal prej 100 lekë.

9. Kur nga kontrolli rezulton se Farmacia është rimbursuar padrejtësisht më tepër (kjo për arsye të vendosjes së kodit të gabuar të barit, në recetë), Farmacia paguan vlerën e përfituar padrejtësisht si dhe kushtin penal prej 5000 lekë.

Të bëhet 500 lekë.

10. Për moszbatim të pikës 2 të kapitullit “Detyrimet e DREJTORISË RAJONALE” të kësaj kontrate, Drejtoria Rajonale paguan kamatë vonesë në masën 0.02%, për çdo ditë vonesë.

Bazuar në ankesat që farmacistët kanë bërë mbi vonesa të gjata në xhirimin e shumës së rimbursuar, shoqëruar edhe me faktin që farmacistë financojnë FONDIN me të paktën dy muaj, kërkojmë që kamatë vonesa të bëhet 0.05 % për çdo ditë vonesë.

11. Për çdo shkelje nga ana e Drejtorisë Rajonale të detyrimeve të saj të parashikuara në kapitullin “Detyrimet e Drejtorisë Rajonale” të kësaj kontrate dhe fshehjes së rezultateve fiktive nga Drejtoria Rajonale, Drejtori i Përgjithshëm i FONDIT përcakton përgjegjësitë dhe merr masë administrative deri në kallzim penal ndaj personave përgjegjës. Për sa më sipër njoftohet Farmacia.

12. Për çdo shkelje nga ana e Drejtorisë Rajonale të detyrimeve të saj të parashikuara në kapitullin “Detyrimet e Drejtorisë Rajonale” të kësaj kontrate, Farmacia ka të drejtë të ankimojë në FOND për mospërmbushjen e detyrimeve brenda 10 ditëve.

13. Farmacia kundrejt sanksioneve të vendosura nga FONDI/Drejtoria Rajonale siç janë kushte penale, shpërblim dëmi, zgjidhje kontrate, ka të drejtë të ankohet brenda 10 ditëve nga dita e marrjes së vendimit për sanksionin e vendosur ndaj saj, pranë Komitetit të Shqyrtimit Administrativ. Komiteti i Shqyrtimit

Administrativ shqyrton ankimimin dhe kthen përgjigje brenda 30 ditëve nga dita e depozitimit të ankimimit. Kundër vendimit Farmacia mund të bëjë ankimim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Proçedura e arkëtimit dhe ekzekutimit të gjobës bëhet në përputhje me ligjin “Për kundravajtjet administrative”.

14. Kur fletëdaljet janë gjendje në Farmaci, por nuk janë të regjistruara në rregjistrin brenda kohës së 7 ditëve nga data e lëshimit, vendoset gjobë në masën 1000 lekë për çdo faturë (fletëdalje).

Afati i regjistrimit të bëhet konform ligjit të procedurave tatimore dhe TVSH 30 ditë.

15. Nëse në recetë ka korrigjim të principit aktiv, formë-dozë apo sasisë së barit, vlera e atij bari nuk rimbursohet.

16. Për shkelje nga ana e Farmacisë, të pikës 2 a. kapitulli “Dorëzimi dhe regjistrimi i të dhënave”, për vonesë në regjistrimin e të dhënave online pas afatit të 48 orëve, në programin e Fond-it, brenda periudhës 15 ditore të dorëzimit të dokumentacionit sipas pikës 1, të po atij kapitulli, Drejtoria Rajonale vendos gjobë në masën 100 lekë për çdo recetë.

Për shkak të mmosfunksionimit të rregullt të programit dhe internetit kërkojmë heqjen e penalitetit.

17. Për shkelje nga ana e Farmacisë, të pikës 3 a, 3 b. kapitulli “Dorëzimi dhe regjistrimi i të dhënave”, për vonesë në regjistrimin online në programin e Fond-it, të inventarit të gjendjes fizike të barnave të listës së barnave që rimbursohen (inventarin në momentin e lidhjes së kontratës si dhe atë të hyrjes në fuqi të listës së barnave që rimbursohen), Drejtoria Rajonale vendos gjobë në masën 1000 lekë.

Penaliteti të jetë 100 lekë

18. Për shkelje nga ana e Farmacisë, të pikës 2 b. kapitulli “Dorëzimi dhe regjistrimi i të dhënave”, për vonesë në regjistrimin e të dhënave hyrje-dalje online pas afatit të 7 ditëve, në programin e Fond-it, Drejtoria Rajonale vendos gjobë në masën 100 lekë për çdo faturë hyrje ose dalje.

19. Për mos deklarim të çdonjërit nga detyrimet e pikës 5 kapitulli “Detyrimet e Përgjithshme”, pas afatit kohor të përcaktuar deri në fund të muajit pasardhës kur është kryer ndryshimi, Farmacia paguan kushtin penal në masën e 20000 lekëve.

Penaliteti të jetë 2000 lekë

20. Për shkelje nga ana e Farmacisë, të pikës 3 b. kapitulli “Dorëzimi dhe regjistrimi i të dhënave”, për vonesë tej afatit të dorëzimit (vetëdeklarimit) të inventarit në formë të printuar, Drejtoria Rajonale vendos gjobë në masën 20000 lekë.

Penaliteti të jetë 2000 lekë

21. Për mosvënien në dispozicion të grupit të kontrollit, brenda 24 orëve, tëçdonjërit nga dokumentacionet e pikës 2, kapitulli Detyrime Specifike, Farmacia paguan kushtin penal prej 10 000 lekë.

Penaliteti të jetë 1000 lekë

22. Për zgjidhje të njëanëshme tëpajustificuar/argumentuar të kontratës nga ana e farmacisë, Farmacia gjobitet në masën 200000 lekë dhe i nështrohet kontrollit me inventar nga Drejtoria Rajonale.

Penaliteti të jetë 2000 lekë

23. Kur nga kontrolli i ushtruar konstatohet se në mjediset e Farmacisë mbahen barna të skaduara (të pa veçuara nga barnat e tjerë dhe të pa shoqëruara me etiketën përkatëse me mbishkrimin të Skaduara/jashtë Përdorimit), Farmacia paguan kushtin penal në masën 5 000 lekë .

Penaliteti të jetë 500 lekë

REDUKTIMI I PENALITETEVE KËRKOHEB BAZUAR NË PROPORCIONALITET DHE PËR ARSYE SE SHKELJET E MËSIPËRME NUK I SHKAKTOJNË DËM EKONOMIK FONDIT. FONDI DUHET TË JETË INSTITUCION QË RIMBURSON BARNAT E LISTES DHE JO INSTITUCION GJOBËVËNËS.

PEZULLIM AKTIVITETI

Në rastet kur ndaj farmacisë fillon ndonjë procedim penal, hetim, nga organi akuzës për çështje që lidhen me pikat e kësaj kontrate, farmacisë i pezullohet aktiviteti kontraktual, deri në përfundimin e plotë të hetimeve. Për këtë periudhë farmacia nuk duhet të ekzekutojë receta me rimbursim pasi nuk i rimbursohet vlera e këtyre recetave.

ZGJIDHJA E KONTRATËS

Kjo kontratë zgjidhet në rastet kur:

1. Ka përfunduar afati i certifikatës së anëtarësimit të drejtuesit teknik, lëshuar nga Urdhëri i Farmacistëve;

2. Në Farmaci gjendet faturë fiktive, receta fiktive të cilat vërtetohen, asaj i zgjidhet kontrata për një periudhë 2vjeçare nga dita e njoftimit zyrtar për këtë zgjidhje, për këtë rast bëhet kallzim penal

3. Mbyllet aktiviteti me një akt të organeve kompetente;

4. Farmacia nuk pranon për kontroll, pa arsye të paraqitura me shkrim specialistë të Drejtorisë Rajonale ose të FONDI-t, të cilët janë të pajisur me fletëidentifikimi dhe urdhër kontrolli, asaj i zgjidhet kontrata për një periudhë 1 vjeçare nga dita e njoftimit zyrtar për këtë zgjidhje.

5. Nga kontrolli në Farmaci (rast i përsëritur) nuk gjendet drejtuesi teknik apo farmacisti i lartë i punësuar por farmacist i pakontraktuar, zgjidhet kontrata nga dita e njoftimit zyrtar për këtë zgjidhje deri në fund të periudhës së kontraktuar, por jo më pak se për një periudhë 6 mujore që nga koha e zgjidhjes.

6. Nga kontrolli në Farmaci, në mungesë të drejtuesit apo të farmacistit të punësuar, gjendet duke shërbyer personi pa paisur me certifikatën e anëtarësimit të Urdhërit të Farmacistëve, farmacisti i zgjidhet kontrata për një periudhë 1 vjeçare nga dita e njoftimit zyrtar për këtë zgjidhje.

7. Nga kontrolli në Farmaci nuk gjendet drejtuesi teknik apo farmacisti i lartë i punësuar por ndihmës farmacisti i punësuar, zgjidhet kontrata nga dita e njoftimit zyrtar për këtë zgjidhje deri në fund të periudhës së kontraktuar, por jo më pak se për një periudhë 6 mujore që nga koha e zgjidhjes.

8. Nga kontrolli me inventarizim i ushtruar në farmaci gjatë periudhës që kjo kontratë është në fuqi rezultojnë diferenca në plus mbi **150.000** lekë, Farmacisti i zgjidhet kontrata deri në fund të periudhës së kontraktuar, por jo më pak se për një periudhë 6 mujore që nga koha e zgjidhjes.

9. Nga kontrolli me inventarizim i ushtruar në Farmaci gjatë periudhës që kjo kontratë është në fuqi rezultojnë diferenca në minus mbi 500 000 lekë, për të gjithë periudhën e kësaj kontrate, përjashtuar barnat e listës O.T.C (barna që jepen pa recetë) të Ministrisë së Shëndetësisë, Farmacisti i zgjidhet kontrata për një periudhë 1 vjeçare, nga koha e zgjidhjes dhe njoftohen organet tatimore për ndjekje të mëtejshme.

Kontrolli i barnave që qarkullojnë me receta pa rimbursim nuk është në kompetencë të FSDKSH, nuk është objekt i kësaj kontrate. FONDIT nuk i shkatohet asnjë dëm ekonomik nga barnat pa rimbursim. Mungojnë aktet nenligjore për recetën tip pa rimbursim, mjekët masivisht nuk përdorin receta tip por i përshtajnë barnat në copa letre, mjekët i detyrojnë pacientët që recetat mos ti lënë në farmaci. Në mungesë të mosdisiplinimit të të gjithë farmaceutëve për tregëtimin e barnave kundrejt recetës tip, pacienti mund ti drejtohet një farmacie pa kontratë.

Nuk ka asnjë logjikë ligjore që të vihet një limit i caktuar për diferenca në minus të pajustificuara.

Nga raportimet që kemi kjo pikë është lënë në dorë të interpretimit të grupeve të kontrollit ose drejtuesve të drejtorive rajonale. Drejtues rajonalë të Fondit akuzohen se kërkojnë rryshfet në këmbim të mosndërprerjes së kontratës kur shuma e diferencave të pajustificuara në minus është mbi 500 000 lekë.

Kërkojmë që të hiqet si pikë.

10. Në rastet kur vërtetohet se Farmacia ka paraqitur për rimbursim në Drejtorin Rajonale ose i konstatohen në ambientet e saj receta që nuk janë ekzekutuar prej saj, Farmacisë i zgjidhet kontrata deri në fund të periudhës së kontraktuar, por jo më pak se për një periudhë 6 mujore që nga koha e zgjidhjes.

11. Në rastet kur vërtetohet se Farmacia ka ekzekutuar recetën duke bërë ndryshimin (konvertimin) e formë-dozës apo principit aktiv të barit të përshkruar në recetë nga mjeku, Farmacisë i zgjidhet kontrata deri në fund të periudhës së kontraktuar, por jo më pak se për një periudhë 6 mujore që nga koha e zgjidhjes.

12. Kur nga kontrolli rezulton se Farmacia tregton barna të Listës së barnave që rimbursohen të papajisur me pullën e kontrollit të Ministrisë së Shëndetësisë (AKBPM-së), Farmacisë i zgjidhet kontrata deri në fund të periudhës së kontraktuar, por jo më pak se për një periudhë 6 mujore që nga koha e zgjidhjes dhe i propozohet institucionit përkatës për heqjen e licensës.

13. Në rastin e recetave me rimbursim të kategorive Veteranë dhe Invalidë lufte, nëse pas verifikimit të recetave vërtetohet se Farmacia nuk ka dhënë barin e përshkruar në recetë nga mjeku por një alternativë më të lirë pa pasqyruar saktë kodin e barit të dhënë, Farmacisë i ndërpritet kontrata për një periudhë jo më pak se 6 mujore që nga koha e zgjidhjes.

14. Për gjetjen në ambjentet e Farmacisë, rast i përsëritur i evidentuar më parë, të kartave të shëndetit/librezave të shëndetit të pacientëve që nuk janë prezent në Farmaci, Farmacisë i zgjidhet kontrata deri në fund të periudhës së kontraktuar, por jo më pak se për një periudhë 6 mujore nga koha e zgjidhjes.

15. Kur nga kontrolli rezulton se Farmacia është rimbursuar padrejtësisht më tepër, rast i përsëritur i evidentuar më parë, si rrjedhojë e vendosjes së kodit të gabuar të barit, në recetë (a. – mospërputhje e kodit me principin aktiv për të gjithë llojet e recetave me rimbursim; b. – mospërputhje e kodit me alternativën e përshkruar të barit brenda të njëjtës formë-dozë të principit aktiv, për recetat e veteranëve dhe invalideve të luftës) Farmacisë i zgjidhet kontrata deri në fund të periudhës së kontraktuar, por jo më pak se për një periudhë 6 mujore nga koha e zgjidhjes.

16. Për vonesë një mujore nga afati i përcaktuar, i dërgimit të të dhënave nga ana e Farmacisë, sipas pikës 2 kapitulli “Dorëzimi dhe Regjistrimi i të Dhënave”, Farmacisë i zgjidhet kontrata për një periudhë kohore jo më pak se 1 vit nga koha e zgjidhjes.

17. Për deklaram të rremë në plotësimin e formularit tip të Vetëdeklarimit, Farmacisë i zgjidhet kontrata deri në fund të periudhës së kontraktuar, por jo më pak se një periudhë 6 mujore nga koha e zgjidhjes.

18. Në raste kur vërtetohet se Farmacia ka ekzekutuar recetën duke i dhënë pacientit barna më pak në sasi ose lloj, se ato të përshkruara në recetë nga mjeku,

Farmacisë i zgjidhet kontrata deri në fund të periudhës së kontraktuar, por jo më pak se për një periudhë 6 mujore nga koha e zgjidhjes .

19. Në rastet kur vërtetohet se Farmacia ekzekuton ose ka ekzekutuar receta me barna të rimbursueshme përtej afatit të tyre të vlefshmërisë(skadencës), Farmacisë i zgjidhet kontrata për një periudhë kohore jo më pak se 1 vit nga koha e zgjidhjes.

20. Kur nga kontrolli në Farmaci konstatohet se:

a) në ambientet e saj ushtrohet aktivitet tjetër privat ose familjar, jo farmaceutik);

b) ambientet e saj komunikojnë direkt(qoftë të ndarë edhe me derë) me ambiente të tjera private ose familjare;

Farmacisë i zgjidhet kontrata për një periudhë 1 vjeçare nga dita e njoftimit për këtë zgjidhje.

21. Për mos deklaram të çdonjërës nga detyrimet(ndryshimet) që rrjedhin nga pika5kapitulli "Detyrime të Përgjithshme", përtej afatit të parashikuar në pikën 19,kapitulli "Sanksionet dhe procedurat e ankimimit", Farmacisë i zgjidhet kontrata për një periudhë 6 mujore nga koha e zgjidhjes.

22. Nëse në aktrakordimin përfundimtar të kontrollit me inventar, mungon drejtuesi teknik, Farmacisë i zgjidhet kontrata për një periudhë 6 mujore nga koha e zgjidhjes.

23. Për vonesë, një muaj nga data e caktuar e dorëzimit të recetave dhe listëtreguesve të tyre, Farmacisë i zgjidhet kontrata për një periudhë 6 mujore nga koha e zgjidhjes.

24. Në çdo rast tjetër që sanksionohet me ligj.

Në të gjitha rastet,zgjidhja e kontratës do të bëhet me një njoftim zyrtar të Drejtorisë Rajonale ku përshkruhet dhe arsyeja për zgjidhjen. Drejtoria Rajonale është e detyruar të bëjë likuidimin e Farmacisë sipas procedurës së përshkruar në këtë kontratë deri në datën kur është marrë njoftim nga ana e Farmacisë për zgjidhjen e kontratës.

PASOJAT E ZGJIDHJES SË KONTRATËS

1. Me zgjidhjen e kontratës dhe mbarimin e afatit të ankimit administrativ, farmacisë nuk i rimbursohen më recetat.

2. Në rastet e zgjidhjes së njëanshme të kontratës (pa marrëveshje mes paleve) nga ana e farmacisë, asaj nuk i rimbursohet vlera e recetave që ajo ka të depozituara në Drejtorinë Rajonale. Në këtë rast Farmacia nuk mund të rilidhë kontratën më shpejt se një periudhë kohore një vjeçare nga koha e zgjidhjes së kontratës.

3.Në rast të mbarimit të afatit të kontratës dhe mos aplikimit për rilidhje në vazhdimësi farmacia nuk gëzon të drejtën e lidhjes së kontratës për një periudhë 1 vjeçare.

Pika 3 është e pabazuar në ligj. Kontrata i shtrin efektet përgjatë perudhës së përcaktuar, Nëse farmacia i është nënshtruar të gjitha detyrimeve kontraktuale është në dëshirën dhe mundësitë e cdo farmacie që të aplikojë kur ta shikojë të arsyeshme rilidhjen e kontratës.

Të hiqet si pikë

DOKUMENTACIONI I FARMACISË

1. Fletëdalja e Importuesit/Shpërndarësit Farmaceutik

Kjo fletë dalje lëshohet nga Importuesi/Shpërndarësi Farmaceutik që ka kontratë me sigurimet shëndetësore.

Fletëdalja e Importuesit/Shpërndarësit Farmaceutik duhet të jetë kompjuterike sipas kërkesave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe programit të FONDI-t e shoqëruar me faturën tatimore sipas kërkesave të Ministrisë së Financave ose fletë dalje tip të miratuara nga Ministria e Financave që plotësojnë dhe kërkesat e Ministrisë së Shëndetësisë .

Fletë dalja e Importuesit/Shpërndarësitfarmaceutik e përshkruar si më sipër nuk do të merret në konsideratë për efekt kontrolli me inventar në rastet kur:

- a.) mungon vula e Importuesit/Shpërndarësitfarmaceutik;
- b.) mungon firma e dhënësit (Importuesit/Shpërndarësitfarmaceutik);
- c.) mungon emri i marrësit (farmacisë);
- d.) mungon fatura tatimore;
- e.) fletëdalja është plotësuar me shkrim dore.

Monedha e përdorur duhet të jetë vetëm leku shqiptar.

Sasitë e barnave në fletëdalje të jenë sipas njësive që i përkasin listës së rimbursimit (ovule, flakon, tablet, ampule, capsule, pena etj...) ose njësi për ambalazh.

1/1. Fletëdalja e Farmacisë për tekImportuesi/Shpërndarësi farmaceutiki origjinës

Kjo fletë dalje lëshohet nga Farmacia vetëm në raste të veçanta kthim bari, për tekImportuesi/Shpërndarësi farmaceutiki origjinës. Fletëdalja duhet të plotësojë të gjitha kërkesat si më lart.

2.regjistri vjetor tip i hyrjeve

Në këtë rregjistër, Farmacia do të pasqyrojë të gjitha fletëdaljet e Importuesit/Shpërndarësitfarmaceutik brenda 7 ditëve kalendarike nga data e lëshimit.

Kur ka korrigjime nëregjistrin e fletëhyrjeve, të cilat përkojnë dhe me korrigjimet në fletë daljet e Importuesit/Shpërndarësit farmaceutik, këto fletë dalje nuk merren në konsideratë gjatë kontrollit me inventar. Regjistri nuk duhet të jetë me faqe mangët.

3. Recetat

a.) Receta me rimbursim të plotë dhe të pjesshëm sipas formatit tip të miratuar nga FONDI.

b.) Recetat pa rimbursim për barnat e Listës sëbarnave qërimburohen (që plotësojnë elementet e domosdoshëm: emër/mbiemër pacienti, vulë personale të mjekut,nr. regjistri/vizitë shtëpie urgjencë,data e lëshimit).

Të hiqet pika b.

4. Listëtreguesit

a.)Listëtreguesit e recetave tip të miratuara nga FONDI.

Listëtreguesit bëhen në dy kopje ku njëra dorëzohet në Drejtorinë Rajonale dhe tjetra qëndron nëFarmaci.

b.) Listëtreguesit e faturave hyrje sipas programit tëFONDI-t.

5. Inventari

Fletë inventari sipas programit informatik tip të miratuara nga FONDI, i plotësuar sipas kërkesave përkatëse.

ANEKS KONTRATE

I. LIDHJA E KONTRATËS PËR HERË TË PARË.

1. Farmacia lidh kontratë për herë të parë me Fondin/Drejtorinë Rajonale të Fondit në rastet kur :
 - a) Hyn në skemën e sigurimeve shëndetësore për herë të parë, pa patur asnjëherë kontratë të mëparshme me Fond-in.
 - b) Ka kontratë me fondin, por ndryshon në të njëjtin moment NIPT-in, Licensën e aktivitetit, Pronarin dhe Drejtuesin Teknik.
 - c) Ka patur kontratë, por i është zgjidhur për një periudhë 1 vjeçare, për zgjidhje të njëanëshme.
 - d) **Ka patur kontratë, por ndryshon vendndodhjen e ushtrimit të aktivitetit.**

Kjo pikë është e pabazuar në ligj, ndryshimi i vendndodhjes së farmacisë shoqërohet me ndryshimet e përcatuara nga ligji i Licencimit dhe nuk shikohet asnjë arsye që të konsiderohet si kontratë e re.

- e) Ndryshon aktivitetin nga agjenci farmaceutike në farmaci.
2. Për të lidhur kontratën Farmacia duhet të bëjë kërkesë me shkrim dhe të dorëzojë pranë FONDIT dokumentacionin sipas gërmave a,b,c dhe g të

mëposhtëme, vetëm pas miratimit të paraqesë(dorëzojë) në Drejtorinë Rajonale të Fond-it të rajonit ku ushtron aktivitetin sa më poshtë:

- a. formularin tip të Vetëdeklarimit (icili mund të printohet tek ëëë.fsdksh.com.al), të dhënat duhet të përputhen me ato të deklaruara në QKR;
- b. kopjen e noterizuar të licencës së ushtrimit të aktivitetit lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit;
- c. kopjen e noterizuar të certifikatës së regjistrimit tatimor, **NIPT dhe QKR**;
- d. kopjen e noterizuar të certifikatës së ushtrimit të profesionit për drejtuesin teknik lëshuar nga Urdhëri i Farmacistëve;
- e. kopjen e noterizuar të kontratës së punës ndërmjet pronarit/përfaqësuesit ligjor me të punësuarit, farmacistë ose nd/farmacistë;
- f. kopjen e noterizuar të certifikatës së anëtarësimit, lëshuar nga Urdhëri i Farmacistëve për farmacistët dhe nd/farmacistët e punësuar. Në rastet kur vendi i punës i farmacistit, nd/farmacistit të punësuar shënuar në certifikatën e anëtarësimit nuk përputhet me subjektin në të cilin ai do të punojë, do të kërkohet(pranohet) vërtetimi i anëtarësimit në Urdhërin e Farmacistëve (origjinal), lëshuar nga Urdhëri i Farmacistëve.
- g. **Genplanin e ambjentit mbi 50 metra katrorë (sipërfaqe e shfrytëzueshme)**
- h. **plan vedosjen e farmacisë, vërtetimin se hyrja e farmacië është në një distancë të tillë jo më pak se 30 m nga hyrja e Qendrës Shëndetësore ose Spitalit, se farmacia nuk është në të njëjtin mur ndarës me Qendrën Shëndetësore ose Spitalin, si dhe atë të largësisë mbi 150 metra të farmacisë nga farmacitë ekzistuese me kontratë, lëshuar nga arkitekt/inxhinier i licensuar.**

Pikat g dhe h janë të pa bazuara në legjislacionin shqiptar, VKM apo rregullore. FONDI nuk mund të marrë kompetencat që ligji ja ka ngarkuar institucioneve të tjera kushtetuese.

Të hiqen si pika

- i. **deklarim për mundësi hyrje të përshtatshme për invalidët para dhe tetraplegjikë, lëshuar nga arkitekt/inxhinier i licensuar;**
Të hiqet për pamundësi në kushtet kur nuk lejohet të bëhen ndërhyrje të tilla nga organet kompetente.
- j. inventarin e gjendjes fizike të barnave të listës së barnave që rimbursohen.

II. RILIDHJA/VAZHDIMI I KONTRATËS

1. Farmacia që ka kontratë në vazhdim me FOND-in dhe që dëshiron të vazhdojë marrëdhëniet kontraktuale, mund të rilidhë kontratë për vitin 2016.
Për të rilidhur kontratën Farmacia duhet të dorëzojë, pranë Drejtorisë Rajonale të Fond-it të rajonit ku ushtron aktivitetin:
 - a. formularin tip të Vetëdeklarimit (i cili mund të printohet tek ëëë.isksh.com.al);
 - b. inventarin e gjendjes fizike të barnave të listës së barnave që rimbursohen (të ditës së fundit të para hyrjes në fuqi të Listës barnave të Rimbursuara.)
 - c. inventarin e gjendjes fizike të barnave të skaduara (nëse ka);

Nëse Farmacia me rilidhjen e kontratës në ndryshim nga viti i mëparshëm,(nga kontrata e mëparëshme) ndryshon njërin nga kriteret: a.-Licensë e aktivitetit, b.- Pronari i aktivitetit, c.-Drejtuesit teknik, d.-të punësuarit farmacistë ose nd/farmacistë, e.-NIPT-in, përveç sa më lart, duhet të dorëzojë edhe kopjen e noterizuar të dokumentit të kriterit.

2. Farmacia mund të rilidhë kontratë me Fondin/Drejtorinë Rajonale kur asaj i është zgjidhur dhe i rilidhet kontrata brenda të njëjtit vit kalendarik. Për të lidhur kontratën Farmacia duhet të paraqesë pranë Drejtorisë Rajonale të Fond-it të rajonit ku ushtron aktivitetin:
 - a) formularin tip të Vetëdeklarimit (i cili mund të printohet tek ëëë.isksh.com.al) të dhënat duhet të përputhen me ato të deklaruara në QKR;
 - b) kopjen e noterizuar të licencës së ushtrimit të aktivitetit lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit;
 - c) kopjen e noterizuar të certifikatës së regjistrimit tatimor, NIPT dhe QKR;
 - d) kopjen e noterizuar të certifikatës së ushtrimit të profesionit për drejtuesin teknik lëshuar nga Urdhëri i Farmacistëve;
 - e) kopjen e noterizuar të kontratës së punës ndërmjet pronarit/përfaqësuesit ligjor me të punësuarit, farmacistë ose nd/farmacistë;
 - f) kopjen e noterizuar të certifikatës së anëtarësimit, lëshuar nga Urdhëri i Farmacistëve për farmacistët dhe nd/farmacistët e punësuar. Në rastet kur vendi i punës i farmacistit, nd/farmacistit të punësuar shënuar në certifikatën e anëtarësimit nuk përputhet me subjektin në të cilin ai do të punojë, do të kërkohet(pranohet) vërtetimi i anëtarësimit në Urdhërin e Farmacistëve (original), lëshuar nga Urdhëri i Farmacistëve;
 - g) inventarin e gjendjes fizike të barnave të listës së barnave që rimbursohen.
3. Drejtoria Rajonale e Fond-it rilidh kontratë me farmacinë, e cila plotëson kriteret përkatëse, brenda 10 ditëve nga afati i dorëzimit të dokumentacionit.
4. Kur Farmacia është e kontraktuar me Fond-in dhe ndryshon njërin nga kriteret: 1.NIPT-in, 2.Licensën e Aktivitetit, 3.Pronarin e aktivitetit, 4.Drejtuesin teknik, bëhet shtojcë kontrate për kriterin/kriteret e ndryshuar. Për të lidhur shtojcë-kontratën Farmacia duhet të dorëzojë brenda 5 ditëve, pranë Drejtorisë Rajonale të Fond-it të rajonit ku ushtron aktivitetin:
 - a) formularin e Përditësimit të Vetëdeklarimit;
 - b) kopjen e noterizuar të dokumentit të kriterit/kritereve të ndryshuar.

ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE

1-Në rast se palët nuk mund të zgjidhin me mirëkuptim mosmarrëveshjet ose konfliktet që mund të lindin në zbatim të kësaj kontrate, palët do t'i drejtohen gjykatës së rrethit ku ushtrojnë aktivitetin.

2-Asnjë nga palët nuk mund të ndryshojë kushtet e kësaj kontrate në mënyrë të njëanëshme.

3-Palët para përfundimit të afatit të kësaj kontrate mund të zgjasin afatin e saj për një kohë të pacaktuar me marrëveshje me shkrim.

4-Me marrëveshje, palët bëjnë ndryshime dhe plotësime të kësaj kontrate duke nënshkruar Shtojcë-Kontratën përkatëse.

AFATET

Kontrata hyn në fuqi më ___/ ___/ 2016 dhe i shtrin efektet deri më ___/ ___2016.

Kontrata bëhet në dy kopje identike me vlerë të njëjtë dhe secila palë merr nga një kopje.

U nënshkrua sot me datë ___/ ___/ ____, në nga

F A R M A C I A

DREJTORIA RAJONALE

Pronari/përfaqësuesi ligjor

Drejtori

/ _____ /

/ _____ /

Vula

Drejtuesi teknik

/ _____ /

Vula